



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2026

VENDIM

Nr. 137, datë 18.03.2026

**PËR
PËRSËRITJEN E KOMANDIMIT TË GJYQTARES ZNJ. ANJEZA BUZO
NË POZICIONIN E KËSHILLTARIT LIGJOR NË NJËSINË MBËSHTETËSE TË
KOMISIONEVE NË KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në nenet 61, 86, shkronja “d” dhe 97 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në nenet 53, 54 dhe 57, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Vendimin e tij nr. 38, datë 31.01.2024 “Për shpalljen e kërkesës për kandidatura nga radhët e gjyqtareve për komandim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, kohëzgjatjen, kriteret dhe procedurën e komandimit”, nr. 155, datë 27.03.2024 “Për komandimin e znj. Anjeza Buzo në Këshillin e Lartë Gjyqësor” pasi shqyrtoi Kërkesën e znj. Anjeza Buzo, protokolluar në Këshill me aktin nr. 1534 prot., datë 10.03.2026, me propozim të Komisionit të Zhvillimit të Karrierës,

VENDOSI:

1. Përsëritjen e komandimit të gjyqtares znj. Anjeza Buzo në pozicionin e “këshilltarit ligjor” në Njësinë Mbështetëse të Komisioneve në Këshillin e Lartë Gjyqësor, për një afat deri në një vit.
2. Efektet juridike të vendimit fillojnë më datë 08.04.2026.
3. Një kopje e vendimit i njoftohet gjyqtares së komanduar znj. Anjeza Buzo sipas kërkesave të shkronjës “c”, pika 1, neni 98, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, në adresën postare elektronike zyrtare, si dhe Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR